



Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 06-8940 /2020

Klinë, dt. 11/03 2020

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 nen d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L040 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, nenit 54, 55 dhe 58 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.20/2016, dispozitat e nenit 3 të Rregullores së MZHE nr.04/2011, dispozitat e nenit 10 të Statutit të Komunës së Klinës, Nr. 01-110-1232/2010 të miratuar më datën 31.03.2010, pas shqyrtimit të Peticionit të qytetarëve të Komunës së Klinës për refuzimin e ndërtimit të fabrikave të çimentos, nr.01-350-6830/2020 të dt.21.02.2020, në takimin e Jashtëzakonshëm të Kuvendit të Komunës së Klinës, të mbajtur më datën 05.03.2020, merret ky:

V E N D I M

1. **ANULOHEN**, të gjitha pëlqimet dhe dokumentet tjera urbanistike që janë dhënë lidhur me guroret për furnizim me lëndë të parë për fabrikat e çimentos.
2. Anulimi si nga pika 1 e këtij vendimi vlen edhe për rastet e ndërtimeve fillestare të fabrikave të çimentos.
3. Obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit që paraprakisht pas pranimit të kërkesave dhe draft- dokumenteve urbanistike sipas këtij vendimi, t'i drejtohet Kuvendit të Komunës.
4. Për të gjithë operatorët ekzistues dhe të rinjë- seperacionet të pezullohen aktivitetet e prodhimit.
5. Pezullimi si në pikën 4 të këtij vendimi hynë në fuqi pas 6 muajve nëse operatorët-seperacionet nuk i plotësojnë kriteret mjedisore sipas lejeve të veçanta për operim dhe pëlqimeve mjedisore.
6. Kërkohet që debatet publike të ndërlidhura me aktivitetet minerare të njoftohen dhe organizohen në objektin e Komunës së Klinës.
7. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, obligohet që t'i anuloi të gjitha pëlqimet e lëshuara për guroret e lëndës së parë për fabrika të çimentos si nga pika 1 dhe 2 e këtij vendimi.
8. Ky vendim hynë në fuqi në përputhje me dispozitat LVL- 03/L-040 e nenit 17 të Rregullores së (MAPL-së), nr.01/2017 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës.

Të njoftohen:

- MAPL;
- Drejtoria e Urbanizmit;
- Kryetari;
- Arkivi.



KUVENDI I KOMUNËS

Kryesuesi,
Fadil Gashi

Arsyetim

Duke marre parasysh Peticionin e parashtruar nga ana e komunitetit- qytetareve të Komunës së Klinës, nr.01-350-6830/2020 të datës 21.02.2020 të nënshkruar nga 3901 qytetare, më kërkesën e Kryetarit të Komunës së Klinës për datën 05.03.2020 është caktuar takim i jashtëzakonshëm i Kuvendit të Komunës për shqyrtimin e peticionit të përmendur.

Kuvendi i Komunës së Klinës ka debatuar peticionin pas prezantimit nga përfaqësuesi i grupit iniciues të peticionit dhe pas shqyrtimit të debatit ka vendosur në mënyrë unanime që kërkesa për anulimin e të gjitha pëlqimeve lidhur me ndërtimin e fabrikave të çimentos të aprovohet si e bazuar. Në këtë takim është marre vendimi për anulimin e të gjitha pëlqimeve dhe dokumenteve tjera urbanistike që janë dhënë lidhur me guroret për furnizim me lëndë të parë për fabrikat e çimentos dhe ndërtimeve fillestare të fabrikave të çimentos.

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës u pajtuan se me rastin e lëshimit të këtyre pëlqimeve nuk janë respektuar procedurat ligjore dhe në rastet konkrete është vepruar pa pajtimin dhe pëlqimin paraprak të komunitetit lidhur me lejimin e aktiviteteve të parapara si ne dispozitiv të këtij vendimi. Pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të anuloj të gjitha pëlqimet lidhur me guroret për furnizim me lëndë të parë për fabrikat e çimentos.